



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E INSPEKTIMIT DHE MBIKËQYRJES

Nr. 248/4 prot.

Tiranë, më 17.03.2026

V E N D I M

Nr. 19, datë 17.03.2026

**MBI PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VLERËSIMIT TË LIGJSHMËRISË, NË
LIDHJE ME VEPRIMET E KRYERA NGA ANA E SUBJEKTEVE TË
NGARKUARA PREJ LIGJIT ME DETYRA SPECIFIKE GJATË REALIZIMIT TË
PROCESIT TË VLERËSIMIT TË REZULTATEVE NË PUNË**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, e ndryshuar, pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në përfundim të verifikimit të veprimeve administrative të kryera gjatë zhvillimit të procedurës së vlerësimit të rezultateve në punë për 6-mujorin e parë të vitit 2025, për nëpunësin Ndriçim Stroka,

VËREJ SE:

Pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil është regjistruar informacioni me shkresën nr. 248 prot., datë 05.02.2026, nëpërmjet të cilit nëpunësi Ndriçim Stroka, me detyrë “Specialist në Sektorin e Shërbimeve nr. 1, Tiranë”, Drejtoria e Metrologjisë Ligjore pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë, ngre pretendime në lidhje me disa parregullsi të lejuara në zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil, gjatë procedurës së ndjekur për vlerësimin e rezultateve në punë, për periudhën Janar – Qershor, viti 2025.

Referuar informacionit dhe dokumentacionit të administruar bashkëlidhur tij, nëpunësi parashtron se, procedura e vlerësimit dhe rivlerësimit të rezultateve në punë për periudhën

Janar – Qershor, viti 2025 është kryer në kundërshtim me kërkesat e ligjit, duke pretenduar: **a)** kapërcim të kompetencave të zyrtarëve që kanë detyrimin për vlerësim të nëpunësit (*Zyrtari raportues apo Zyrtari kundërfirmues*); **b)** mungesën e komenteve dhe argumentimit për mënyrën e vlerësimit; dhe **c)** mosrespektimin e fazave të procesit të vlerësimit.

Në këto kushte, nëpunësi ka kërkuar ndërhyrjen e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për verifikimin dhe vlerësimin e ligjshmërisë së veprimeve të krijuara nga ana e subjekteve të ngarkuara prej ligjit me detyra specifike gjatë aplikimit të institutit të vlerësimit të rezultateve në punë.

Pasi u njoh me pretendimet e parashtruara nga nëpunësi në fjalë, në mbështetje të kompetencave ligjore të sanksionuara në pikën 1, të nenit 11 dhe nenin 14, të ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, Komisioneri ka filluar procesin e verifikimit të informacionit, nëpërmjet shkresës nr. 248/1 prot., datë 16.02.2025, “*Kërkesë për dokumentacion në lidhje me verifikimin paraprak të informacionit të dërguar pranë Komisionerit me shkresën e rregjistruar me nr.248 prot., datë 05.02.2026, të dërguar nga punonjësi Ndricim Stroka*”, duke vënë në dijeni edhe institucionin të cilit i ka kërkuar dokumentacionin që materializon procesin e vlerësimit të punës për punonjësin N. Stroka.

Në përgjigje të kësaj kërkesë, nëpërmjet shkresës nr. 476/1 prot., datë 20.02.2026, “*Kthim përgjigje*”, të Drejtorit të Përgjithshëm, të institucionit në fjalë, protokolluar pranë Komisionerit me nr. 248/2 prot., datë 24.02.2026, është dërguar dokumentacioni i kërkuar.

Nga analiza e materialeve të administruara, rezulton se, nëpunësi Ndricim Stroka, me aktin nr. 5015 prot., datë 16.10.2020, të Departamentit të Administratës Publike, është emëruar si nëpunës civil në pozicionin e punës “*Specialist në Sektorin e Shërbimeve nr. 1, Tiranë*”, Drejtoria e Metrologjisë Ligjore pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë.

Referuar përcaktimeve të pikës 1, të nenit 62, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, vlerësimi i rezultateve në punë është procesi i **a)** verifikimit të realizimit të përgjithshëm të objektivave të përcaktuara në fillim të periudhës së vlerësimit, si edhe i **b)** aftësive ose dobësive të nëpunësit në kryerjen e detyrave, i cili realizohet çdo 6 muaj.

Më tej, në kreun IV, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 109, datë 26.2.2014, “*Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë*”, i ndryshuar, parashikohet se, vlerësimi i rezultateve në punë për nëpunësit civilë bëhet sipas lidhjes nr. 1 dhe nr. 2, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

Në rastin e punonjësit Ndricim Stroka, sa i takon procesit të vlerësimit të punës për periudhën Janar-Qershor 2025, ku është vlerësuar në nivelin 3, “*Kënaqshëm*”, rezulton se

Komisioneri e ka trajtuar më parë këtë çështje, nëpërmjet shkresës nr. 834/10 datë 21.11.2025, “Kthim përgjigje në lidhje me informacionet e administruara pranë Komisionerit me shkresat nr. 808, datë 16.9.2025 dhe nr. 834 prot., datë 29.9.2025”, duke orientuar institucionin për ndjekjen e disa fazave procedurale të parashikuara posaçërisht nga legjislacioni i shërbimit civil gjatë aplikimit të institutit të vlerësimit.

Ndërkohë, gjatë procesit të verifikimit të rastit, Komisioneri është informuar nga ana e intitucionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë, se nëpunësi në fjalë, i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për zgjidhjen e çështjes, proces i cili është në vijim. Pranë Komisionerit është dërguar nga institucioni edhe vendimi me nr.regj. Them. 11727, datë regjistrimi 05.12.2025, “Për caktimin e seancës përgatitore”, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, dhe kërkesëpadia e paditësit Ndriçim Stroka, me palë të paditur institucionin e Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë.

Nisur nga gjithë sa më sipër, bazuar në parimin e sanksionuar në nenin 36, të ligjit nr. 8116, datë 29.03.1996, “Kodi i Procedurës Civile” i ndryshuar, në përmbajtje të së cilit sanksionohet se, asnjë institucion tjetër shtetëror nuk mund të trajtojë çështje që po trajtohen apo janë trajtuar nga sistemi gjyqësor, vlerësojmë se, Komisioneri nuk mund të vijojë më tej, procedurën e hetimit të këtij rasti, pasi kjo mosmarrëveshje është bërë objekt i shqyrtimit gjyqësor, në përfundim të së cilit do të jepet zgjidhje përfundimtare pas trajtimit në themel të rastit.

Për këtë arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të Ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; nenin 1, pika 2, të ligjit nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar; nenin 36, të ligjit nr. 8116, datë 29.03.1996, “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe nenin 16, pika 6), e Rregullores “Për procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, e ndryshuar,

VENDOSA:

1. Përfundimin e hetimit administrativ dhe arkivimin e çështjes, të filluar në bazë të informacionit nr. 248 prot., datë 05.02.2026, të paraqitur nga nëpunësi Ndriçim Stroka, pasi mosmarrëveshja është bërë objekt i shqyrtimit gjyqësor dhe do të zgjidhet në themel nga gjykata kompetente.

2. Të njoftohet për këtë vendim institucioni i Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë, si dhe nëpunësi Ndriçim Stroka.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Lefterije Lleshi (Luzi)